



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1154 / 15 Prot.

Vlorë më 15.08.2022

VENDIM

Nr. 24, datë 15.08.2022

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË DHE
PËRJASHTIM NGA TARIFA PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 23. 01. 2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21. 12. 2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, të ndryshuar", VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29. 03. 2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me shkresën nr.1084 prot, datë 26.07.2022 në mbledhjen e datës 15.08.2022 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e bursës për 1 (një) student, për vitin akademik 2021- 2022, me efekt financiar 86,935 lekë.
2. Të miratojë përjashtimin nga tarifa e shkollimit për 1 (një) student, për vitin akademik 2021- 2022, me efekt financiar 20,000 lekë
3. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al